

SYLLABUS i Lëndës: Struktura dhe rritja ekonomike - Niveli Bachelor

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Ekonomik
Titulli i lëndës:	Struktura dhe rritja ekonomike
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Elective
Viti i studimeve:	3
Numri i orëve në javë:	2 + 1
Vlera në kredi – ECTS:	4
Koha / lokacioni:	<i>Caktohet nga dekanati në fillim të vitit</i>
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof.asoc.Dr. Driton Qehaja
Detajet kontaktuese:	Fakulteti Ekonomik, UP, Kabineti 87 E-mail: driton.qehaja@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	Hyrje në modelin e rritjes neoklasike- temë e makroekonomisë modern dhe një rishikim i teorisë së rritjes endogjene. Temat do të përfshijnë fakte themelore të rritjes ekonomike dhe zhvillimit ekonomik afatgjatë; përmbledhje e shkurtër e teorisë optimale të kontrollit dhe modelimit dinamik; modeli bazë i rritjes neoklasike në një shumëllojshmëri të strukturave të tregut; kapitali njerëzor dhe rritja ekonomike; modelet e rritjes endogjene; modele me teknologji endogjene; modelet e ndryshimeve teknologjike; konkurrenca, struktura dhe rritja e tregut; financiare dhe ekonomike; tregtinë ndërkombëtare dhe rritjen ekonomike; institucioneve dhe zhvillimit ekonomik.
Qëllimet e lëndës:	Ky kurs synon: 1. Pajisja e studentëve me konceptet themelore në lidhje me strukturën dhe teorinë e rritjes ekonomike. Studentët do të mësojnë faktet themelore të rritjes ekonomike dhe zhvillimit afatgjatë ekonomik, funksionimin e ekonomisë kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe politikat ekonomike të zbatueshme. 2. Pajisja e studentëve me konceptet bashkëkohore makroekonomike, të cilat mund të përdoren për të diskutuar dhe vlerësuar në mënyrë kritike politikat aktuale makroekonomike. 3. Sigurimi i një pasqyre të diskutimeve rreth zhvillimet aktuale për sa i përket rritjes ekonomike dhe pabarzise.

Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi studenti do të jetë në gjendje që të: - Analizojnë se si shtetet mund të arrijnë rritje të lartë dhe të qëndrueshme. - të kuptojnë determinantët e rritjes, si dhe se si politikat ndikojnë në rritjen ekonomike. - të kuptojnë se investimi në kapitalin fizik dhe njerëzor, së bashku me inflacionin e ulët dhe politikat e tregtisë së hapur, janë të nevojshme për rritjen ekonomike. - analizojnë se si qeveritë në vendet në zhvillim kanalizojnë më shumë para në programet e arsimit dhe punës së kapitalit, si investimi në infrastrukturë dhe shëndetësi. - të kuptojnë se rritja e një vendi gjatë një periudhe të gjatë përcaktohet në thelb nga tre faktorë: (1) shfrytëzimi efikas i burimeve ekzistuese (2) akumulimi i burimeve produktive si kapitali njerëzor, dhe (3) progres teknologjik. - të analizojnë dhe të studiojnë tutje këto kategori të gjera të cilat ndahen më tej në përcaktues të ndryshëm të rritjes ekonomike.		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënës të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet			
Ushtrime në teren			
Kollokfiume, seminare	2	2	4
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanë të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgaditja përfundimtare për provim	3	4	12
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	4	8
Projektet, prezentimet ,etj			
Totali			100
Metodologjia e mësimdhënies:	Çdo javë mbahen nga 2 orë ligjërata. Pas çdo ligjërate jepen detyra, të cilat diskutohen në javën		

	në vijim. Studentët inkurajohen që të përcjellin rrjedhat ekonomike në vend, gazetatat, revistat dhe internetin dhe të nxjerrin tema për diskutim. Esetë e përgatitura lidhur me këto çështje merren parasysh në vlerësim. Mësimdhënia do të përqendrohet në pjesëmarrjen aktive të studentëve në procesin e mësimit, me prezantime individuale e grupe, me komente mbi ligjëratën/prezantimin e mësimdhënësit etj.
Metodat e vlerësimit:	Në mënyrë që të ketë një vlerësim sa më të drejtë të punës së studentëve gjatë gjithë vitit, nota përfundimtare është rezultat i aktivitetit të studentëve të treguar gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve, vlerësimeve paraprake dhe një provimi përfundimtar. Pyetja do të jete me shkrim. Pyetjet formulohen prej materialit mesimorë që ligjrohet në klase dhe kanë formën e pyetjeve të shkurtra dhe /ose në forme të tjera. Menyra e vlerësimit: • 10 % të notës finale - Pjesëmarrje aktive në klasë. • 10% të notës finale - Zhvillimi dhe prezantimi i punimit seminarik. • 80% të notës finale - Dy teste që përfaqësojnë: ○ 40% të notës finale - Testi i parë (Testi i parë përfshinë rreth 50% të materialit mesimor) ○ 40% të notës finale - Testi i dytë (Testi i dytë përfshinë rreth 50% të materialit mesimor) • Nuk ka nevojë që të nënshtroheni testit final NESE kalohen dy testet, dhe nëse jeni të rregullt dhe aktiv në ligjerata, si dhe nëse zhvilloni punimin seminarik. • Nëse nuk kaloni njerin nga testet e parapara, keni mundësi ta perseritni vetëm një herë, njerin nga testet që nuk keni kaluar. Nëse edhe herën e dytë, nuk e kaloni njerin nga testet e parapara, do të nënshtroheni testit final-testit të përgjithshëm. • Testi final: për të kaluar testin e përgjithshëm, studentet duhet që të arrijnë së paku 51% të pikeve të parapara. Koment: nëse nuk kalohen testet, nuk merret

	parasysh pjesemarrja aktive ne klase e as punimi seminarik. Gjatë vlerësimit do të merren parasysh, përveç tjerash, edhe këto aspekte: - interpretimi i temës, - thellësia e të kuptuarit të temës, - shfrytëzimi i literaturës, - evaluimi dhe sinteza e evidencës, - analizat kritike dhe - logjika e ndërtimit të argumentit. Përveç kësaj, vëmendje në vlerësim do tu kushtohet edhe: - drejtshkrimit, - prezantimit vizual të të dhënave dhe referencave, - gjatësisë së shkrimit dhe - prezantimit të përgjithshëm.
Literatura	
Literatura bazë:	1. Sala-i-Martin, Xavier; Barro, Robert J. (2003). Economic growth (2nd ed.). Massachusetts: MIT Press. ISBN 9780262025539. 2. N. Gregory Mankiw. Macroeconomics Worth Publishers; 8th edition (June 1, 2012)
Literatura shtesë:	• Acemoglu, Daron. Introduction to Modern Economic Growth. Princeton, NJ: Princeton University Press, 2008. ISBN: 9780691132921. • Aghion, P. and S. Durlauf, editors, Handbook of Economic Growth (2 volumes), North-Holland: Amsterdam, 2005 • Jessica Cohen and William Easterly, Editors, What Works in Development? Thinking Big and Thinking Small, Brookings Institution Press: Washington DC, 2009 • Nunn, Nathan, "The Importance of History for Economic Development," Annual Review of Economics, Vol. 1, No. 1, September 2009, pp. 65-92

	Deaton, Angus, "Instruments of development? Randomization in the tropics, and the hunt for the keys to development", January 2010, Princeton University
--	---

Plani i dizajnuar i mësimi:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	1. GDP – Matja e ekonomisë
<i>Java e dytë:</i>	2. Perlllogaritja e rritjes ekonomike
<i>Java e tretë:</i>	3. Hyrje në Rritjen ekonomike 3.1. Rritja, varfëria dhe mirëqenia: Shpërndarja botërore e të ardhurave individuale
<i>Java e katërt:</i>	4 Shpërndarja e të ardhurave përkohë banori
<i>Java e pestë:</i>	5 Modeli Solow-Swan. 5.1. Modeli Neoklasik
<i>Java e gjashtë:</i>	6. Debati i Konvergjencës
<i>Java e shtatë:</i>	7. Modeli Ramsey.
<i>Java e tetë:</i>	8. Ekonomitë e hapura
<i>Java e nëntë:</i>	9. Discussions and 1 test
<i>Java e dhjetë:</i>	10. Ndryshimi Teknologjik: Paragjykimi endogjen i Aftësive dhe Ndryshimet teknologjike endogjene që rritin punësimin
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	11. Konkurrenca dhe Ndryshimet Teknologjike
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	12. Qeveria dhe Financat Publike
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	13. Shpenzimet publike dhe të mirat publike Shpenzimet qeveritare dhe rritja endogjene
<i>Java e katërmëdhjetë:</i>	14. Kapitali njerëzor. Matja e kapitalit njerëzor
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	15. Ekonomiksi I ideve.

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
Pjesëmarrja në ligjërata dhe ushtrime është e obligueshme. Studentët inkurajohen që gjithmonë të kërkojnë sqarime gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve. Mësimdhënësi do të jetë në dispozicion për sqarime shtesë dhe konsultime të studentëve. Studentët kanë për obligim që pas çdo ligjërate të lexojnë së paku literaturën që ju është caktuar dhe të kryejnë detyrat dhe esetë që do t'u jepen. Studentët nuk janë të obliguar tu nënshtrohen vlerësimeve gjatë semestrit. Studentet inkurajohen të përcjellin diskutimet në media dhe të hapin diskutime lidhur me to. Studenti duhet të jetë i ndërgjegjshëm dhe të respektojë institucionin dhe rregullat shkollore. Duhet të respektojë orarin e ligjëratave, ushtrimeve dhe të jetë i vëmendshëm në orën mësimore. Është i obliguar posedimi dhe paraqitja e indeksit në teste dhe provim. Gjatë hartimit të punimeve seminarike, studenti duhet ti përmbahet udhëzimeve të dhëna nga mësimdhënësi për realizimin hulumtues dhe teknik të punimit.